



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1352/6 prot

Datë 18.10.2021

V E N D I M
Nr. 774/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.10.2021 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-97322-06-03-2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane) në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier”, me fond limit 198,984,172.17 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme e prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK
Adresa: Rr. “Hasim Vokshi”, pallati “Albuilding & 2T”, kati 2,
Tiranë.

Operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK
Adresa: Lagjja “Bishanak”, Rr. “Nezir Frakulla”, Fier

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Adresa: Lagjja “Kastriot”, Rr. “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.06.2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-97322-06-03-2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane) në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë

Administrative të Bashkisë Fier”, me fond limit 198,984,172.17 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.07.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1. “Alko Impex Construction” SHPK | 194,165,013.77 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Kombi Invest” SHPK | 197,168,192.07 lekë, Kualifikuar; |
| 3. “Victoria Invest” SHPK | 160,489,298.19 lekë, Skualifikuar; |

II.3. Në datën 16.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.4. Në Buletinin Nr. 111 datë 19.07.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik është publikuar formulari i njoftimit të fituesit, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK.

II.5. Në datën 13.07.2021, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

“1. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2019 dhe 2020, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”, të përcaktuar në pikën 3.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 e DST. Referuar kontratave për kryerjen e shërbimeve të ngjashme të deklaruar nga vetë subjekti ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK ka nënshkruar kontratë publike me autoritet kontraktorë për shërbime publike në vitin 2019, për të cilin në bazë të nenit 40 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, në bazë të nenit 3.1/a,b,c të Ligjit nr.131/2015 “Për QKB”, si dhe bazuar në Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ka pasur detyrimin të regjistrohet me NIPT detyësor, të deklarohet dhe të regjistrohet në QKB, si dhe të paraqiste në këtë tender vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, ku ka ushtruar aktivitetet. Konkretisht, referuar dokumentacionit të ofertës në SPE, OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK ka nënshkruar më datë 20.08.2019 kontratë publike me AK Bashkia Kavajë, me objekt “Shërbim i pastrimit të qytetit Kavajë”, ndërkohë që bazuar mbi këtë fakt, si dhe bazuar në nenin 40 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, në bazë të nenit 3.1/a,b,c të Ligjit nr.131/2015 “Për QKB”, si dhe bazuar në Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, OE ofertues ka pasur detyrimin të regjistrohet me NIPT detyësor, të deklarohet dhe të regjistrohet në QKB. Referuar Ekstraktit Historik të OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK, konstatohet se ky subjekt ka hapur NIPT detyësor në Bashkinë Kavajë vetëm në datë 12.08.2020, pra nuk është regjistruar në QKB në vitin 2019, për

aktivitetin e ushtruar në Bashkinë Kavajë në vitin 2019 (Numri i çështjes: CN-574698-08-20 Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitimi i vendimit datë 11.08.2020, për hapje adrese dytësore. Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit: është Shtuar Adresa: "Tiranë; KAVAJË; Kavajë; KAVAJË; Zona kadastrale nr.8551, pasuria me numër 12/5;). Në vijim të sa më sipër, konstatohet se OE ofertues, ka pasur detyrimin të paraqiste për këtë tender, vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga Bashkia Kavajë, por ky subjekt nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse (Bashkia Kavajë) për vitin 2019, ku ka ushtruar aktivitet, siç kërkohet në pikën 3.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 e DST. Subjekti ofertues ka paraqitur në tender deklaratë me anë të së cilës “deklaroi se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019-2020 tek të gjitha vendet ku ka ushtruar dhe ushtron aktivitetin ekonomik”, por kjo deklaratë është në kushtet e deklaratës së rreme, parashikuar nga gërma “ë”, pika 3, neni 76 i ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

2. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, siç kërkohet në pikën 3.3.7, (gërma f), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST, ”Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.” Konkretisht, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për mjetet që shënohen në regjistrat publikë (me targë), për të cilët Ofertuesi ka detyrimin ligjor të shoqërojë gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, konstatohet se për 4 (katër) mjetet e marra me qira (kamionçina), certifikatat e lëshuara nga njësi vendore për transport mallrash, janë cilësuar “Transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, pra qiradhënësi e ka për përdorim vetjak, ndërkohë që OE ofertues i ka marr me qira mjetet: Kamionçinë me targë AA 586 MS (kapaciteti mbajtës 1550 kg); Kamionçinë me targë AA 589 MS (kapaciteti mbajtës 3000 kg); Kamionçinë me targë AA 792 PY (kapaciteti mbajtës 3000 kg); Kamionçinë me targë AA 618 GM (kapaciteti mbajtës 1650 kg); siç rezulton nga dokumentacioni i paraqitur në SPE dhe shtojca mbi disponimin e makinerive. Në këto rrethana, kryerja e transportit nga ana e operatorit ekonomik ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK me kamionçinat e shoqërisë qiradhënëse “ALKO-IMPEX General Construcion” ShPK me NUIS K91326028I, do të jetë në kushtet e kryerje së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për transportin rrugor” është i ndaluar. Dhënia e tyre me qira është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. AK gjykon se leja (licenca) e transportit të mallrave është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatori ekonomik ofertues. Mungesa e kësaj leje vërteton faktin se përdorimi i mjetit do të ishte i pamundur, në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”, pra legjislacionit në fuqi. (arsye skualifikimi bazuar në qëndrimet e konsoliduara të

KPP-së, shih vendimin e KPP-së 609/2020 datë 30.12.2020, vendimin nr.544/2019 datë 15.08.2019). Për sa cituam më lart, paraqitja e dokumentacionit lidhur me këto mjete do të konsiderohet i pasaktë, jo në përputhje kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST, dhe për rrjedhojë nuk do të konsiderohet i vlefshëm. Në këto kushte, OE ofertues ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 1 (një) mjet transporti vetëshkarkues me kapacitet deri në 3.5 ton, nga 4 (katër) të kërkuar në DST, pasi për 4 (katër) mjetet kamionçina të sipërcituara, të marra me qira, nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues të rregullt, prandaj nuk e plotëson këtë kriter kualifikimi.

3. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, siç kërkohet në pikën 3.3.7, (gërma g), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST. Deklarata e OE ofertues mbi angazhimin e mjeteve, ka përmbajtje në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga AK në pikën 3.3.7, (gërma g), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST. Në këtë kriter kualifikimi AK ka kërkuar shprehimisht që Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë, ndërsa OE ofertues në Deklaratën e tij është shprehur se “Mjetet e deklaruara në Shtojcë janë në gjendje të mirë pune dhe në rast se shpallemi fitues nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër, por vetëm për kontratë”. Kjo deklaratë vjen në kundërshtim me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga çdo operator ekonomikë ofertues dhe të cilat i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet e duhura, makineritë, pajisjet dhe asete të tjera fizike, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.”

II.5.1. Në datën 21.07.2021, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1352/2 prot, datë 22.07.2021, u publikuan arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK, si dhe u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK pretendon se nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK.

II.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK nuk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente sipas

parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK.

II.5.4. Me anë të shkresës nr. 5120/13 prot., datë 26.07.2021, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1352/3 prot., datë 28.07.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorët ekonomikë ankimues mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.5.5. Me anë të shkresës nr. 1352/4 prot., datë 30.07.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për depozitimin e ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e tyre, vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, si dhe dokumentacionin provues lidhur me vendimmarrjen për anulimin e procedurës së prokurimit.

II.5.6. Në datën 09.08.2021, me shkresën nr. 5120/15 prot., datë 05.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1352/5 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në të cilin konstatohet se autoriteti kontraktor nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e ankimuesit për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit.

II.6. Në datën 26.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.7. Në Buletinin Nr. 117 datë 02.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik është publikuar formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Kjo procedurë prokurimi publik anulohet bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Fier nr.50 datë 23.07.2021 “Për miratimin e vazhdimin të kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit të Bashkisë Fier”, me anë të së cilit është vendosur anulimi i kësaj procedure prokurimi dhe miratimi i kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane) në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit të Bashkisë Fier. [...]”

II.8. Në datën 30.07.2021 operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.8.1. Në datën 02.08.2021 operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në datën 30.07.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.8.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1415/2 prot., datë 30.07.2021, u publikua objekti i ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction”.

II.8.3. Në datën 12.08.2021, me shkresën nr. 7220/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 1415/3 prot., është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Në datën 03.08.2021 operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.9.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1436/2 prot., datë 04.08.2021, u publikua objekti i ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest”.

II.9.2. Në datën 12.08.2021, me shkresën nr. 7228/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 1436/3 prot., është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, mbi vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në datën 21.07.2021, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Me anë të shkresës nr. 5120/13 prot., datë 26.07.2021, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1352/3 prot., datë 28.07.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Me anë të shkresës nr. 1352/4 prot., datë 30.07.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për depozitimin e ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e tyre, vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, si dhe dokumentacionin provues lidhur me vendimmarrjen për anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.4. Në datën 26.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

III.1.5. Në Buletinin Nr. 117 datë 02.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik është publikuar formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Kjo procedurë prokurimi publik anulohet bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Fier nr.50 datë 23.07.2021 “Për miratimin e vazhdimin të kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit të Bashkisë Fier”, me anë të së cilit është vendosur anulimi i kësaj procedure prokurimi dhe miratimi i kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane) në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit të Bashkisë Fier. [...]”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 3 të tij janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.1.7. Në nenin 110 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

III.1.8. Në nenin 112 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.9. Lidhur me procedurën e ndjekur nga autoriteti kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni konstaton se megjithëse ka pasur një ankesë brenda afateve ligjore nga operatori ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm procedurale duke njoftuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin, duke shkelur përcaktimet e pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi me marrjen e ankesës, autoriteti kontraktor duhet të kishte pezulluar procedurën e prokurimit dhe nuk duhet të kishte kryer asnjë veprim deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me ankesën. Komisioni sqaron se vendimi i autoritetit kontraktor Bashkia Fier për anulimin e procedurës së prokurimit është një akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) si çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektësh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ për anulimin e procedurës së prokurimit, kjo procedurë ka qenë e pezulluar. Në konceptin juridik “Pezullimi” është një moment juridik që ndërpret në mënyrë të menjëhershme dhe për një kohë të caktuar fuqinë juridike të aktit (në rastin konkret veprimet e autoritetit kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit). Në nenin 108 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”.

Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se proceduralisht akti i anulimit të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me ligjin, ndaj Komisioni ndodhet në kushtet e konstatimit *prima facie* të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, konstaton se akti administrativ i publikimit të njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK qëndrojnë.

III.1.10. Ndërsa lidhur me arsyet e anulimit të procedurës së prokurimit, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor Bashkia Fier e ka anuluar këtë procedurë prokurimi në zbatim të Vendimit nr. 50, datë 23.07.2021 të Këshillit të Bashkisë Fier, në të cilin ky i fundit ka vendosur si më poshtë vijon:

“1. Të miratojë kryerjen e shërbimit të Pastrimit dhe largimit të Mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative me punonjës të Bashkisë Fier”

2. Të miratojë rritjen e numrit të punonjësve të Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit me 35 (tridhjetë e pesë) punonjës. Numri i Punonjësve të Bashkisë Fier ishte 1390 bëhet 1425 punonjës

3. Të ngarkojë ekzekutivin e Bashkisë Fier të kryejë të gjitha procedurat ligjore për anulimin e procedurës së prokurimit “Për kryerjen e Shërbimit të Pastrimit dhe largimit të Mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative”

4. Të ngarkojë ekzekutivin e Bashkisë Fier të bëjë ndryshimet e nevojshme në strukturën organizative të Ndërmarrjes së pastrim Gjelbërimit.

5. Të ngarkojë ekzekutivin e Bashkisë Fier të bëjë ndryshimet e nevojshme në Buxhetin e Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit, brenda totalit të shpenzimeve të miratuara në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2021.

6. Të ngarkojë ekzekutivin e Bashkisë Fier të kryejë rregullimet e nevojshme në Rregulloren përkatëse të Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

8. Ky vendim hyn në fuqi, sipas Ligjit”

III.1.11. Në nenin 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, përcaktohet, si më poshtë:

“1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.

2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.

4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.

5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.

6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.”

III.1.12. Në nenin 64 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, përcaktohet, si më poshtë:

“Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
- b) zbaton aktet e këshillit;
- c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësisve administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;
- d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;
- dh) është anëtar i këshillit të qarkut;
- e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;
- ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësisve administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;
- f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;
- g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësisve në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
- gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;
- h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;
- j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;
- l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.”

III.1.13. Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
- d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.1.14. Sa më sipër, Komisioni konstaton se Këshilli i Bashkisë Fier, me anë të Vendimit nr. 50, datë 23.07.2021, ka vendosur që shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative do të bëhet me punonjës të Bashkisë Fier, si dhe ka ngarkuar ekzekutivin e Bashkisë Fier të kryejë të gjitha procedurat ligjore për anulimin e procedurës së prokurimit “Për kryerjen e Shërbimit të Pastrimit dhe largimit të Mbeturinave në Njësitë Administrative dhe kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative”. Lidhur me vlefshmërinë e Vendimit të mësipërm të Këshillit të Bashkisë Fier, Komisioni sjell në vëmendje nenin 23 “Verifikimi i kompetencës” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës Së Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi. 2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.” Komisioni i Prokurimit Publik, referuar kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se shqyrtimi i aktit administrativ nr. 50, datë 23.07.2021 i Këshillit të Bashkisë Fier, është jashtë kompetencës lëndore të KPP-së. Komisioni sqaron se kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e një organi që të vendosë për çështje të veçanta nga tërësia e çështjeve administrative. Çdo organ ka kompetencën e tij lëndore për të vendosur në çështje të caktuara administrative, prandaj ai duhet të ketë kujdes që të vendosë vetëm mbi ato çështje për të cilat ka kompetencë lëndore. Caktimi i kompetencës lëndore bëhet me dispozitat që rregullojnë një fushë të caktuar ose që caktojnë kompetencat e organeve të veçanta administrative.

III.1.16. Të ndodhur në kushtet e përmendura më sipër, ku nga njëra anë anulimi i procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi nga autoriteti kontraktor është kryer proceduralisht në kundërshtim me ligjin, çka e bën aktin për anulimin e procedurës absolutisht të pavlefshëm, por nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik ndodhet në kushtet e pamundësisë për të vendosur mbi vlefshmërinë e aktit administrativ nr. 50, datë 23.07.2021 të Këshillit të Bashkisë Fier, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore, Komisioni gjykon të vendosë vetëm mbi anulimin aktet administrative nr. 5120/10 prot., datë 23.07.2021 dhe nr. 5120/12 prot., datë 23.07.2021 për anulimin e procedurës së prokurimit, si akte absolutisht të pavlefshëm. Gjithashtu, Komisioni gjykon ti tërheqë vëmendjen autoritetit kontraktor që në të ardhmen të zbatojë me përpikëri përcaktimet në nenin 112 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyen: “[...]1. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2019 dhe 2020, pranë njësisive

vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”, të përcaktuar në pikën 3.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 e DST. Referuar kontratave për kryerjen e shërbimeve të ngjashme të deklaruara nga vetë subjekti ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK ka nënshkruar kontratë publike me autoritet kontraktorë për shërbime publike në vitin 2019, për të cilin në bazë të nenit 40 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, në bazë të nenit 3.1/a,b,c të Ligjit nr.131/2015 “Për QKB”, si dhe bazuar në Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ka pasur detyrimin të regjistrohet me NIPT dytësor, të deklarohet dhe të regjistrohet në QKB, si dhe të paraqiste në këtë tender vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, ku ka ushtruar aktivitetet. Konkretisht, referuar dokumentacionit të ofertës në SPE, OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK ka nënshkruar më datë 20.08.2019 kontratë publike me AK Bashkia Kavajë, me objekt "Shërbim i pastrimit të qytetit Kavajë", ndërkohë që bazuar mbi këtë fakt, si dhe bazuar në nenin 40 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, në bazë të nenit 3.1/a,b,c të Ligjit nr.131/2015 “Për QKB”, si dhe bazuar në Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, OE ofertues ka pasur detyrimin të regjistrohet me NIPT dytësor, të deklarohet dhe të regjistrohet në QKB. Referuar Ekstraktit Historik të OE ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK, konstatohet se ky subjekt ka hapur NIPT dytësor në Bashkinë Kavajë vetëm në datë 12.08.2020, pra nuk është regjistruar në QKB në vitin 2019, për aktivitetin e ushtruar në Bashkinë Kavajë në vitin 2019 (Numri i çështjes: CN-574698-08-20 Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitimi i vendimit datë 11.08.2020, për hapje adrese dytësore. Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit: është Shtuar Adresa: "Tiranë; KAVAJË; Kavajë; KAVAJË; Zona kadastrale nr.8551, pasuria me numër 12/5;). Në vijim të sa më sipër, konstatohet se OE ofertues, ka pasur detyrimin të paraqiste për këtë tender, vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga Bashkia Kavajë, por ky subjekt nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse (Bashkia Kavajë) për vitin 2019, ku ka ushtruar aktivitetet, siç kërkohet në pikën 3.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 e DST. Subjekti ofertues ka paraqitur në tender deklaratë me anë të së cilës “deklaron se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019-2020 tek të gjitha vendet ku ka ushtruar dhe ushtron aktivitetin ekonomik”, por kjo deklaratë është në kushtet e deklaratës së rreme, parashikuar nga gërma “ë”, pika 3, neni 76 i ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” [...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, pika 2.2.a “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë: “3.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2019 dhe 2020, pranë njësave vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi”

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm, ndër të tjera, operatori ekonomik

“Alko Impex Construction” SHPK ka dorëzuar vërtetimin nr. 21 prot., datë 10.03.2021, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kavajë.

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar parashikohet se: “1. Taksapaguesi regjistrohet çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. 2. Regjistrimi për herë të parë bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë biznesin. Gjatë këtij regjistrimi taksapaguesi detyrohet të japë të dhënat e mëposhtme: a) vendimin e gjykatës për regjistrimin, kur regjistrimi në gjykatë është i detyrueshëm; b) certifikatën personale me fotografi; c) adresën e vendndodhjes së biznesit; ç) llojin e biznesit që kryen në atë vendndodhje; d) çdo të dhënë ose dokument tjetër, që mund të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave. 3. Taksapaguesi është i detyruar të deklarojë pranë bashkisë ose komunës të gjitha ndryshimet e ndodhura (nëse ka ndryshime në vendndodhjen ose llojin e biznesit që kryen), brenda afatit prej 15 ditësh nga çasti i ndryshimit. Procedurat e deklaramit të

ndryshimeve pranë bashkisë apo komunës përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. 4. Bashkia ose komuna bën regjistrimin e taksapaguesit, kur ai nuk regjistrohet ose nuk reregjistrohet në kohën e duhur. Ky regjistrim ka të njëjtin efekt me regjistrimin ose reregjistrimin e kryer nga vetë taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 17 të këtij ligji. 5. Bashkia ose komuna pajis me certifikatë regjistrimi çdo taksapagues, i cili ka përfunduar procesin e regjistrimit ose të reregjistrimit, në përputhje me udhëzimin. Në certifikatë shënohen numri i identifikimit të taksapaguesit, lloji i veprimtarisë dhe adresa e vendndodhjes së biznesit. Numri i identifikimit është unik, në shkallë kombëtare dhe përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, sipas nenit 4 të këtij ligji. 6. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje.

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Nga interpretimi i nenit 12 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, KPP konstaton se marrëdhëniet juridike dhe njëherazi detyrimet, mes një subjekti juridik privat dhe njësisë të qeverisjes vendore, lindin vetëm në momentin kur subjekti juridik ushtron veprimtari pranë territorit të njësisë administrative. Nga ky moment juridik, rrjedh njëherazi dhe e drejta e njësisë administrative për vjeljen e taksave respektive dhe lëshimit të vërtetimit ndaj subjektit nëse ka shlyer të gjithë detyrimet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit të kualifikimit, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur vërtetimin nr. 21 prot., datë 10.03.2021, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kavajë, në të cilin vërtetohet se: “[...]ka shlyer detyrimet pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kavajë, deri më datë 31.12.2020 [...]”. Referuar kriterit të kualifikimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon që të vërtetojë që operatorët ekonomikë ofertues të mos kenë detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifavat vendore, për vitet 2019 dhe 2020 pranë njësisë vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin. Nga shqyrtimi, i vërtetimit nr. 21 prot., datë 10.03.2021, Komisioni gjykon se institucioni lëshues i vërtetimit, e ka hartuar këtë dokument duke vërtetuar në mënyrë shteruese dhe përfshirëse se operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, ka shlyer detyrimet deri në datën 31.12.2020. Pra, me anë të këtij vërtetimi vërtetohet se ankimuesi ka shlyer detyrimet deri në datën e cituar, duke përfshirë të gjitha detyrimet që mund të kenë lindur ndaj këtij institucioni vendor, përfshirë edhe detyrimet e mundshme të vitit 2019. Komisioni thekson se, vërtetimi nuk vërteton pagesën vetëm për detyrimet e vitit 2020, në mënyrë që të konsideroheshin të pavërtetuara detyrimet e lindura në

vitin 2019. Në këto kushte, Komisioni gjykon se arsyetimi i autoritetit kontraktor se ankimuesi nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj Bashkisë Kavajë nuk është i bazuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyen: “[...]2. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”, siç kërkohet në pikën 3.3.7, (gërma f), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST, ”Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.” Konkretisht, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për mjetet që shënohen në regjistrat publikë (me targë), për te cilët Ofertuesi ka detyrimin ligjor të shoqëroje gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, konstatohet se për 4 (katër) mjetet e marra me qira (kamionçina), certifikatat e lëshuara nga njësia vendore për transport mallrash, janë cilësuar “Transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, pra qiradhënësi e ka për përdorim vetjak, ndërkohë që OE ofertues i ka marr me qira mjetet: Kamionçinë me targë AA 586 MS (kapaciteti mbajtës 1550 kg); Kamionçinë me targë AA 589 MS (kapaciteti mbajtës 3000 kg); Kamionçinë me targë AA 792 PY (kapaciteti mbajtës 3000 kg); Kamionçinë me targë AA 618 GM (kapaciteti mbajtës 1650 kg); siç rezulton nga dokumentacioni i paraqitur në SPE dhe shtojca mbi disponimin e makinerive. Në këto rrethana, kryerja e transportit nga ana e operatorit ekonomik ofertues “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK me kamionçinat e shoqërisë qiradhënëse “ALKO-IMPEX General Construcion” ShPK me NUIS K91326028I, do të jetë në kushtet e kryerje së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për transportin rrugor” është i ndaluar. Dhënia e tyre me qira është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. AK gjykon se leja (licenca) e transportit të mallrave është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjete është në përdorim nga operatori ekonomik ofertues. Mungesa e kësaj leje vërteton faktin se përdorimi i mjetit do të ishte i pamundur, në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”, pra legjislacionit në fuqi. (arsye skualifikimi bazuar në qëndrimet e konsoliduara të KPP-së, shih vendimin e KPP-së 609/2020 datë 30.12.2020, vendimin nr.544/2019 datë 15.08.2019). Për sa cituam më lart, paraqitja e dokumentacionit lidhur me këto mjete do të konsiderohet i pasaktë, jo në përputhje kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST, dhe për rrjedhojë nuk do të konsiderohet i vlefshëm. Në këto kushte, OE ofertues ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 1 (një) mjet transporti vetëshkarkues me kapacitet deri në 3.5 ton, nga 4 (katër) të kërkuar në DST, pasi për 4 (katër) mjetet kamionçina të

sipërcituara, të marra me qira, nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues të rregullt, prandaj nuk e plotëson këtë kriter kualifikimi[...]", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8, pika 3.3.7 "Kapaciteti teknik", të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

"3.3.7 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Mjete teknologjike me kapacitet mbajtës 6 – 12 ton, koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6	3 copë	Pronësi ose me qira
Mjete transporti vetëshkarkuese me kapacitet deri 3.5 ton	4 copë	Pronësi ose me qira
Skrepa APV, me dy kova (një para dhe një prapa)	2 copë	Pronësi ose me qira
Mjet për shkriçimin (krehjen) e rërës, për mirëmbajtjen e plazheve	1 copë	Pronësi ose me qira

Është e mjaftueshme paraqitja e dokumentacionit si më poshtë:

- Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit, janë shkak skualifikimi."

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimi të kriterit të mësipërm lidhur me disponimin e 4 mjeteve të transportit vetëshkarkuese me kapacitet deri 3.5 ton, operatori ekonomik "Alko Impex Construction" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë qiraje nr.4256rep., nr.1612kol., datë 22.06.2021, lidhur ndërmjet shoqërisë "Alko Impex Construction" SHPK në cilësinë e qiramarrësit dhe shoqërisë "Alko Impex General Construction" DSHH, me objekt dhënien me qira të disa mjeteve, ku ndër to janë mjetet: Kamionçinë me targë AA586MS; Kamionçinë me targë AA589MS; Kamionçinë

me targë AA792PY; Kamionçinë me targë AA618GM, shoqëruar me Leje qarkullimi; Certifikatë të kontrollit teknik; Policë për sigurimin e detyrueshëm; Certifikatë pronësie; Mandat-pagesa e taksave vjetore të mjetit; Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vetë; fotografi të mjetit.

- Leje qarkullimi; Certifikatë të kontrollit teknik; Policë për sigurimin e detyrueshëm; Certifikatë pronësie; Mandat-pagesa e taksave vjetore të mjetit; fotografi të mjetit; për mjetin me targë AA874XI në pronësi të shoqërisë “Alko Impex Construction” SHPK

III.3.3. Në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.4. Në Udhëzimin nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, pika 2 e Aneksit 2 parashikohet se:

“2. Në llojet e mallrave për transport brenda vendit, që nuk kanë nevojë për certifikatë përfshihen:

- Mallrat që transportohen me mjete që përfshihen në pikën 1 të këtij aneksi, kur ato punojnë për llogari të vetë;
- Transporti i mbeturinave që dalin nga pastrimi i qyteteve dhe shërbimeve të tjera publike në qytete;
- Çimento rifuxho nga fabrika për në objektet e ndërtimit;
- Furnizimi i njësisve tregtare me vezë, peshk i freskët, perime të freskëta, qumësht e prodhime të tij, kur ato ndodhen brenda qytetit;
- Furnizimi i farmacive ose spitaleve me barna mjekësore brenda qytetit;
- Transporti i postës, kur mjetet janë pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Postave;
- Transporti i prodhimeve nga fermat bujqësore e blegtorale për në fabrikat e përpunimit;
- Transporti i orendive, mobilieve dhe sendeve të tjera shtëpiake, si dhe orendi e pajisje zyrash;
- Transporti i sendeve apo lëndëve të konsumit publik si libra, pajisje shkollash, spitalesh apo qendra shëndetësore, apo qendra kërkimore shkencore;
- Transporti i sendeve dhe lëndëve të forcave të armatosura;
- Në të gjitha rastet e mësipërme, subjekti pronar i mjetit, vërteton me dokumente zyrtare të lëshuara prej tij llojin e destinacionin e mallrave, me përjashtim të Forcave të Armatosura.

Kur mallrat e mësipërme transportohen për llogari të subjektit me mjete jo në pronësi të tij, mjetet e transportuesit që ofron shërbimin me pagesë duhet të jenë pajisur me certifikatë, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.”

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të posedojnë mjetet përkatëse, të pajisura me dokumentacionin e duhur, për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor, ndër të tjera, për mjetet e transportit ka kërkuar leje transporti për transport mallrash.

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumentacioni të paraqitur nga ankimuesi, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se dokumentacioni i paraqitur për mjetin me targë AA874XI, në pronësi të operatorit ekonomik ankimues është në përputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Ndërsa sa i takon mjeteve të transportit vetëshkarkuese Kamionçinë me targë AA586MS, Kamionçinë me targë AA589MS, Kamionçinë me targë AA792PY, Kamionçinë me targë AA618GM janë paraqitur certifikatat e transportit brenda vendit për llogari të vet. Nga shqyrtimi relacionit teknik të shërbimit objekt prokurimi, Komisioni konstaton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar se këto mjete do të përdoren për transportin e mbetjeve dhe transportin e kontejnerëve, por pa e ndarë sasinë e mjeteve që nevojiten për secilin funksion transportues. Bazuar në përcaktimet e Udhëzimit të sipërcituar, për transportin e mbetjeve, mjetet e transportit nuk kanë nevojë të pajisen me certifikatë/leje transporti të çfarëdolloji. Nga ana tjetër, Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor, qëllimi kryesor është garantimi që operatorët ekonomikë posedojnë mjetet vetëshkarkuese të pajisura me dokumentacionin e duhur në mënyrë që të zbatojnë me sukses kontratën objekt-prokurimi, si dhe të mos krijojnë problematika me autoritetet përkatëse ligjzbatuese. Në këtë kuadër, referuar Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, me anë të dokumentacionit të paraqitur, për sa kohë nuk është përcaktuar sasia e mjeteve që do të përdoren për transporte të tjera nga ato të mbetjeve, operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin me disponimin e mjetit targë AA874XI, ndërsa lidhur me mjetet e tjera që do të përdoren për transportimin e mbetjeve nuk është e nevojshme pajisja me certifikatë/leje transporti. Në këto kushte Komisioni gjykon se ankimuesi e përmbush kriterin e vendosur në shtojcën 8, pika 3.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyen: “[...]3. OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e

kontratës”, siç kërkohet në pikën 3.3.7, (gërma g), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST. Deklarata e OE ofertues mbi angazhimin e mjeteve, ka përmbajtje në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga AK në pikën 3.3.7, (gërma g), të rubrikës 2.Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8 të DST. Në këtë kriter kualifikimi AK ka kërkuar shprehimisht që Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë, ndërsa OE ofertues në Deklaratën e tij është shprehur se “Mjetet e deklaruar në Shtojcë janë në gjendje të mirë pune dhe në rast se shpallemi fitues nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër, por vetëm për kontratë”. Kjo deklaratë vjen në kundërshtim me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga çdo operator ekonomik ofertues dhe të cilat i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet e duhura, makineritë, pajisjet dhe asete të tjera fizike, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8, pika 3.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit, janë shkak skualifikimi.”

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm ka paraqitur deklaratën me përmbajtje si vijon: “[...]Mjetet e deklaruar në shtojcë janë në gjendje të mirë pune dhe në rast se shpallemi fitues nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër, por vetëm për këtë kontratë. Gjithashtu janë të disponueshme për verifikim fizik të tyre gjatë gjithë periudhës së vlerësimit të ofertave në adresat e mëposhtme:...”

III.4.3. Në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të posedojnë mjetet përkatëse, të pajisura me dokumentacionin e duhur, për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i deklaratës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni gjykon se ky i fundit nuk e ka plotësuar në formën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, duke e ndryshuar kohën e foljes nga në të tashmen, në të ardhmen. Por, Komisioni gjykon se pavarësisht hartimit të deklaratës në formën jo të kërkuar nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk i është kufizuar mundësia KVO-së që të kryej verifikimet e nevojshme në adresën e deklaruar. Komisioni thekson se, në deklaratën e paraqitur është përcaktuar adresa, ku KVO mund të kryejë verifikimet e nevojshme lidhur me mjetet e kërkuara. Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor është më e rëndësishme që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë mjetet e nevojshme për zbatimin e kontratës se sa forma e aktit të kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Kombi Invest” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorin ekonomik të renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. Për këtë arsye këto pretendime nuk merren në shqyrtim.

III.6. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, Komisioni vëren, se në datën 26.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

III.6.1. Në datën 03.08.2021 operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

III.6.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1436/2 prot., datë 04.08.2021, u publikua objekti i ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest”.

III.6.3. Në datën 12.08.2021, me shkresën nr. 7228/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 1436/3 prot., është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur

me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.6.4. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.6.5. Në nenin 134 pika 2 të ligjit nr.162/2020 ” Për prokurimin publik”, ku parashikohet se “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet”. Kështu, në nenin 8 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si akt në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit, parashikohet se: “1.Në përputhje me nenin 27 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

-2.400.000.000 (dy miliard e dyqind milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

-200.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 8.000.000 (tetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektorale.”

III.6.6. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.6.7. Në datën 12.10.2021, me anë të shkresës nr. 1436/4 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekrani” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijani nga ankimuesi mbi njoftimin e anulimit.

III.6.8. Në datën 14.10.2021, është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa e operatorit ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, nr. 117 prot., datë 14.10.2021 me anë të së cilës ka bashkëlidhur “Printim ekrani” të rubrikës mesazhe në llogarinë e tij në SPE, vërtetohet se operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK është njoftuar nëpërmjet SPE lidhur me njoftimin e anulimit.

III.6.9. Bazuar në verifikimet në SPE, ku rezulton se procedura e prokurimit është kombëtare, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar, në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të përllogaritet sipas përcaktimeve për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur anulimin e procedurës së prokurimit. Referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në datën 26.07.2021, ndërkohë që për këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 03.08.2021.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik pas afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret, bazuar në faktin që ankimuesi është vënë në dijeni më anë të SPE mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, afati maksimal i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik është data 02.08.2021.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 03.08.2021, konsiderohet e paraqitur pas afatit të fundit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.6.8. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit

Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën nr. 1415 prot., datë 30.07.2021, e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-97322-06-03-2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane) në Njësitë Administrative dhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier”, me fond limit 198,984,172.17 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën nr. 1352 prot., datë 21.07.2021, e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të shpallë absolutisht të pavlefshëm aktet administrative nr. 5120/10 prot., datë 23.07.2021 dhe nr. 5120/12 prot., datë 23.07.2021 për anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.
5. Autoriteti kontraktor kontraktor të zbatojë pikat e mësipërme të dispozitivit në përputhje më arsyetimet në këtë vendim sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, si dhe brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për ankesat nr. 1415 prot., datë 30.07.2021 dhe nr. 1352 prot., datë 21.07.2021.

7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri